

Festa e Përkryer e Papás

Po sikur shiu të mos pushonte?



NGANJËHERË SHIU NUK PUSHON

Jo të gjitha lutjet marrin menjëherë përgjigje, siç mori lutja e Aleksit. Por Perëndia gjithmonë na dëgjon dhe dëshiron shumë të na bekojë. Ne mund të zgjedhim të mirëbesojmë se Ai e di çfarë është më e mira, madje edhe kur gjërat nuk duken se shkojnë siç duhet.

Nga Dejvid Dikson
(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

Kjo histori ndodhi në Samoa.

Re të errëta, të zymta rrinin pezull në qiell. Aleksit ua nguli sytë me inat.

BUUM!

Gjëmuan më shumë bubullima. Pika shiu të mëdha e të rënda përplaseshin kudo.

Aleksit tundi kokën. S'dukej mirë. Aspak mirë. Nganjëherë në Samoa, binte shi pa pushim për ditë me radhë. Por ai donte që ditëlindja e gjyshit të tij të ishte e përkryer!

Aleksit shkoi në dhomën e tij dhe u gjuhëzua pranë shtratit të tij.


"Atë i Dashur Qiellor", – tha ai. "Të lutem largoje shiun nesër gjatë festës së ditëlindjes së Papás [gjyshit]. I kemi shpërndarë ftesat tashmë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen."

Kur Aleksit u ngrit, ai pa mamin dhe babin që po qëndronin në pragun e derës së tij. Ata po buzëqeshnin.

"Shpresoj mos ta kesh problem që ta dëgjuam lutjen", – tha mami.

Aleksit buzëqeshi. "S'ka problem. Dua vetëm që nesër të jetë një ditë e veçantë për Papán. Nuk do të jetë njësoj po të na duhet të qëndrojmë brenda. Nuk do të kishim vend për të kërcyer!"

Babi ia shtrëngoi supin Aleksit. "Sido që të jetë moti, Papá do ta dijë se sa shumë ti e do atë."



Mëngjesin tjetër, mami dhe babi i kërkuan Aleksit të bënte lutjen familjare. Po binte ende shumë shi. Dhe ende nuk dukej se do të pushonte.

"Të lutem bekoje shiun që të largohet në kohën e festës", – tha ai. "Dhe të lutem të na bekosh të gjithëve që t'ia kalojmë mirë. Veçanërisht Papán!"

Aleksit e vështroi qiellin gjithë mëngjesin. Për një kohë të gjatë, asgjë nuk ndryshoi. Por më pas ndodhi diçka e mrekullueshme.



"Shiko!" – bërtiti Aleksit. "Një copë qielli i kaltër!" Familja e tij doli me vrap në oborr. Retë kishin filluar të largoheshin.

Për pak orë, retë u larguan të gjitha! Edhe pellgjet në tokë ishin tharë. Aleksit nxitoi të zburonte oborrin. Papá dhe të ftuarit e tjerë do të mbërrinin këtu së shpejti.

Kur Papá mbërriti aty, u befasua. Pa dritat, shiritat shumëngjyrësh dhe gjithë të ftuarit. "Gjithçka duket bukur", – tha ai. "Shumë faleminderit!"

ILLUSTRIMET NGA AUGUSTO ZAMBONATO

Festa që aq zbavitëse sa e kishte shpresuar Aleksit. Ata kërcyen këngët e parapëlqyera të Papás. Ushqimi ishte i shijshëm – veçanërisht buka e ëmbël me arrë kokosi. Aleksit madje arriti të këndonte me Papán.

Pjesa më e bukur, sidoqoftë, që kur erdhi koha për Siva Tauluga-n. Ky kërcim interpretohej gjithmonë nga njeriu më i rëndësishëm i ditës. Dhe, s'do mend, që ai ishte Papá!

Papa u ngrit për të kërcyer, por pastaj pa Aleksit. "Eja kërcëjmë bashkë, Aleks!" – thirrri Papá. Aleksit hop u ngrit dhe kërcëu pranë Papás. Shpejt u ngritën të kërcenin edhe të gjithë të tjerët.

Papá u përkul që ta përqaftonte Aleksin. "Sot më ke bërë të ndihem tepër i veçantë", – tha Papá. "Kjo ishte festa e përkryer e ditëlindjes."

Pasi mbaroi festa, Aleksit vështroi qiellin lart. Retë e dendura të zeza ishin kthyer. Shi filloi sërish të binte çurg mbi ta. Por këtë herë, Aleksit nuk e kishte problem. Ai e dinte se Ati Qiellor e kishte ndihmuar motin të ishte i mirë aq kohë sa duhej për festën e Papás.

"Të falënderoj për motin e mirë", – u lut Aleksit. "Dhe të falënderoj për një Papá kaq të mrekullueshëm."